SEI ARRIVATO IN ITALIA!

ERDHE NË ITALI!



në kujdesin e

CIR
CONSIGLIO ITALIANO PER I RIFUGIATI ONLUS

me ndihmën e

UNHCR
The UN Refugee Agency

SEI ARRIVATO IN ITALIA!

ERDHE NË ITALI!

në kujdesin e

CIR
CONSIGLIO ITALIANO PER I RIFUGIATI ONLUS

me ndihmën e

UNHCR
The UN Refugee Agency

Broshurë informuese shumëgjuhëshe për të miturit e huaj të pashoqëruar që vijnë në Itali, e redaktuar për projektin "Strengthening guardianship system in Sicily and legal information at the northeast border" realizuar nga Këshilli Italian për Refugjatët – CIR në bashkëpunim me Agjencinë Onu për Refugjatët – UNHCR

Figurat e Kopertinës dhe Illustrimet në brendësi:
Maria Tomaselli

Projekti Grafik dhe paraqitja grafike:
Citrino Visual&Design Studio

Shtypi:
Grafica Goriziana sas

Shtyi përfundoi në qershor 2019


GERMANY
AUSTRIA
HUNGARY
FRANCE
SWITZERLAND
ITALY
SLOVENIA
CROATIA
SERBIA
BOSNIA
HERZEGOVINA
MACEDONIA
ALBANIA
GREECE
TUNISIA
ALGERIA
LIBYA


RUSSIA
SEI ARRIVATO IN ITALIA!
BULGARIA
TURKEY



ÇFARË MUND TË NDODHË PAS ARDHJES TËNDE NË ITALI...

Nëse je arratisur nga vendi yt ose ke qenë në rrezik në vendin tënd të lindjes ose në vendet ku ke kaluar, mund të kërkosh azil në Itali, thuaja menjëherë personave me uniformë (Forcat e Policisë).

Nëse je në moshë më të vogël se 18 vjeç, ke lindur në një shtet jashtë Bashkimit Evropian e ndodhesh në Itali pa prindërit ose pa ndonjë familiar në moshë madhore, për ligjin italian je një i mitur i pashoqëruar dhe ke të drejtë për mbrojtje. Nuk mund të mos pranohesh ose të dëbohesh dhe ke të drejtë të qëndrosh në Itali në mënyrë të ligjshme deri të paktën sa të mbushësh moshën madhore (18 vjeç).

Pas ardhjes në Itali mund të ndalohesh nga personat me uniformë (Forcat e Policisë). Nëse nuk të ndalojnë, shko tek ata sa më shpejt që të jetë e mundur. Mos ki frikë, thuaj menjëherë që je më i vogël se 18 vjeç dhe kërko ndihmë, ata janë aty për të të dëgjuar e për të të ndihmuar.

Personat me uniformë do të të pyesin për emrin, mbiemrin, moshën dhe vendin ku ke lindur. Është e rëndësishme që të thuash të vërtetën. Në Itali kur gënjen personat me uniformë është kundër ligjit e pasojat janë të renda (dënime penale), edhe kur je i mitur.
Nëse nuk kupton çfarë thonë ose shkruajnë personat me uniformë, thuaju atyre të marrësh informacione të sakta me ndihmën e një përkthyesi/ndërmjetësi kulturor që flet gjuhën tënde dhe sigurohu me ndihmën e tij që të dhënat të jenë shkruar në mënyrë të saktë.

Nëse ke dokumente, tregoja menjëherë personave me uniformë. Mund të ndodhë që, nëse ke pasaportë, ta mbajnë por duhet të të japin një kopje. Kërko që tek kopja të jetë shkruar vendi, data dhe emri e mbiemri i personit që të mban dokumentin.

Nëse je në moshë më të madhe se 14 vjeç do të të bëjnë disa foto dhe do të të marrin shenjat e gishtërinjve. Nëse je më pak se 14 vjeç personat me uniformë nuk mund të të marrin shenjat e gishtërinjve.

Pas identifikimit tënd, personat me uniformë do të të shoqërojnë në një qendër pritjeje për të mitur.

Nëse identifikohesh gabimisht si një person që është më i madh se 18 vjeç dhe ju çojnë në një qendër mikpritjeje për të rritur, thuaja menjëherë operatorëve të qendrës: do të të ndihmojnë që të identifikohesh saktë dhe të transferohesh në një qendër pritjeje për të mitur.

Nëse je me moshë më të madhe se 18 vjeç por identifikohesh gabimisht si i mitur dhe të presin në një qendër pritjeje për të mitur, thuaja operatorëve të qendrës të cilët do të të shpjegojnë të drejtat dhe detyrimet e tua dhe pasojat e korrigjimit të të dhënave personale. **Kujtohu që të deklarosh të dhëna falso është kundër ligjit dhe ka pasoja negative (dënime penale).**

Të rriturit dhe të miturit kanë nevoja të ndryshme dhe qëndrimi në të njëjtën qendër mund të shkaktojë probleme për të dyja palët.



NË RASTIN KUR ËSHTË I NEVOJSHËM VERIFIKIMI I MOSHËS SË MITUR...

Nëse nuk ke dokumente dhe personat me uniformë (Forcat e Policisë) dyshojnë për faktin se ti je në moshë më të vogël se 18 vjeç:

- mund të kërkosh që të dërgojnë dokumentet e tua nga Vendi yt ose nga Ambasada e Vendit tënd. Nëse nuk do që të kontaktojnë Ambasadën sepse ke frikë, thuaje menjëherë e asnjë nuk do ta kontaktojë.

- personat me uniformë (Forcat e Policisë) mund t'i kërkojnë Autoriteteve Gjyqësore autorizimin për të kryer verifikimin e moshës.

Personat me uniformë (Forcat e Policisë) duhet të të shpjegojnë, me një përkthyes/ndërmjetës kulturor, se si kryhet verifikimi i moshës.

Autoritetet gjyqësore mund të lejojnë verifikimin e moshës pas miratimit tënd. Fol me operatorët e qendrës së pritjes dhe me tutorin tënd!

Ke të drejtë të shoqërohesh për të kryer verifikimin e moshës, ashtu si e parashikon ligji, nga përgjegjësi i qendrës ku qendron ose nga tutori yt (shiko poshtë për sqarimin e rolit të tutorit), por mund të ndodhë që të jesh vetëm. Në çdo rast përkthyesi/ndërmjetësi kuturor duhet të jetë gjithmonë me ty për të të shpjeguar si si kryhet kjo procedurë. Nëse nuk ta kanë shpjeguar më parë, pyet për të ditur se çfarë po bëjnë dhe përse.

Ke të drejtë të kesh një kopje të rezultateve të analizës në gjuhën që kupton.

Nëse, pas analizave, do të verifikohet që je në moshë të mitur, mund të vazhdosh të qëndrosh në qendër pritëse për të miturit e pashoqëruar.

Nëse, në të kundërt, do të verifikohet që je në moshë më të madhe se 18 vjeç, mund t'u drejtohesh organizatave që merren me qytetarët e huaj në moshë madhore dhe, nëse mendos se rezultati i verifikimit është i gabuar, mund të apeloheni me ndihmën e një avokati.



DO TË PRESIN NË NJË QENDËR PRITËSE PËR TË MITUR... Ç'DO TË NDODHË NË KËTË QENDËR...

Mund të ndodhë që të transferojnë nga qendra pritëse e parë në një qendër tjetër për të huaj të mitur të pashoqëruar në një vend tjetër pak orë ose pak ditë më pas.

Pas mbërritjes tënde në qendër operatorët, me një ndërmjetës kulturor, do të të informojnë për të drejtat dhe detyrimet e tua në Itali dhe do të të bëjnë pyetje për ty, familjen tënde, jetën tënde në vendin e lindjes, për arsyet që të shtynë të lësh familjen dhe vendin tënd dhe për udhëtimin që ke bërë. Të gjitha këto pyetje nuk duhet të të trëmbin, i duhen personave që do të kujdesen për ty për të të njohur dhe për të kuptuar si mund të të ndihmojnë.

Operatorët e qendrës do të të bëjnë fotografi e më pas do të të shoqërojnë në Polici, e cila do të të identifikojë përsëri, do të të marrë shenjat e gishtërinjve e do të lëshojë një leje qendrimi.

Leja e qendrimit është një dokument që bën të mundur identifikimin tënd, duhet të marrësh gjithmonë me vete, ose kopje sipas rastit, dhe t'ia tregosh personave me uniformë nëse ta kërkojnë.
Leja e qendrimit çertifikon të drejtën tënde për të qëndruar në Itali e të lejon një shumëllojshmëri shërbimesh si lëshimi i kodit fiskal dhe regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar për të marrë kujdesin mjekësor, regjistrimi në kurset e italishtes/kurse edukimi/ kurse profesionale, regjistrimi në aktivitete sportive, etj.

Në qendrën e pritjes mund të të jepet pocket money. Pocket money ndryshon sipas llojit të qendrës. Pocket money nuk është një e drejtë, është një kontribut dhe një mjet edukimi dhe integrimi.

Të kesh një telefon celular nuk është një e drejtë. Kontaktimi i familiarëve të tu do të sigurohet me anën e mjeteve të qendrës pritëse. Në disa raste përdorimi i celularit tënd mund të kontrollohet ose kufizohet për mbrojtjen tënde. Celulari është një mjet i dobishëm, por ndonjëherë mund të jetë i dëmshëm e bile mund të jetë i dëmshëm për sigurinë tënde.

Nëse ke probleme ose frikë nga dikush, mundohu të flasësh me një person të besueshëm. Mos ki frikë të flasësh, operatorët e qendrës dhe tutori janë aty për të të dëgjuar dhe për të të ndihmuar. Gjithçka që i tregon operatorëve është private dhe do të mbetet sekret.

Kujtohu që në Itali, burrat dhe gratë kanë të njëjta të drejta. Në Itali askush nuk mund të mohojë të drejtat e tua sepse je një vajzë

Ki durim: është një proces i gjatë!



KUSH ËSHTË TUTORI YT?

Kur je në moshë më të vogël se 18 vjeç e gjendesh në Itali pa prindërit ose pa një anëtar tjetër të familjes në moshë madhore që kujdeset për ty duke të shoqëruar për të marrë vendimet e duhura për ty, Gjykata për të miturit zgjedh një tutor për ty.

Tutori është një person në moshë madhore, jashtë qendrës së pritjes, i cili të përfaqëson, të shoqëron e të mbështet në disa raste të parashikuara nga ligji dhe do të firmosë për ty disa dokumente, për shembull në rastin e analizave dhe/ose vizitave dhe/ose kurave shëndetësore, e regjistrimit shkollor, e kryerjes së kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare etj.

Tutori do të vijë në qendrën e pritjes për të të njohur e do ta takosh përsëri kur ta kesh të nevojshme.

Nuk është e detyrueshme të kalosh kohën me tutorin.

Mbase do të kalojë një periudhë kohe para se Gjykata për të miturit të emërojë tutorin. Deri sa të emërohet tutori, përgjegjësi i qendrës do të jetë tutori yt i përkohshëm.



E DREJTA PËR BASHKIM FAMILJAR

Nëse je në kontakt me familjarët e tu, mund t'i dëgjosh për t'u thënë që je mirë e mund t'i dëgjosh rregullisht me ndiihmën e operatorëve të qendrës. Nëse nuk je në kontakt me familjen tënde, por di si t'i kontaktosh të afërmit e tu, kërko ndihmë tek operatorët e qendrës për t'i kontaktuar.

Nëse nuk je në kontakt me familjarët e tu për çfarëdo arsye, për shembull sepse je shkëputur nga ata gjatë udhëtimit, njofto menjëherë personat me uniformë ose operatorët e qendrës së pritjes, do të të ndihmojnë për të gjetur familjen tënde.

Nëse ke të afërm/familjarë (baba, nënë, vëlla/motër, gjysh/gjyshe, xhaxha/dajë/hallë/teze, kushëri/kushërirë) në Itali ose në vendet e tjera evropiane ku dëshiron të shkosh, operatorët do të të shpjegojnë si mund të veprosh për të shkuar tek ata në mënyrë të sigurtë e do të të ndihmojnë ta bësh.



CILAT JANË TË DREJTAT E TUA?

Ke të drejtë të marrësh pjesë në mënyrë të ndërgjegjshme duke marrë informacionet e duhura në të gjitha procedurat shëndetësore, administrative dhe gjyqësore që të përkasin.

Nëse ndihesh keq, thuaja operatorëve të qendrës së pritjes. Ke të drejtë të marrësh menjëherë përkujdesin shëndetësor/psikologjik për të cilin do të kesh nevojë. Në Itali ka doktorë meshkuj dhe femra.
Mund të kërkosh të vizitohesh nga një doktor i të njëjtës gjini me tënden. Në vizitë mund të marrë pjesë edhe një ndërmjetës që flet gjuhën tënde për të të shpjeguar çfarë ndosh.

Ke të drejtë të informohesh nga operatorët dhe nga ndërmjetësi kulturor për të drejtat e tua.

Ke të drejtë të të dëgjojnë e të shprehësh mendimin tënd për projektin tënd të jetës. Por kjo nuk do të thotë që të gjitha kërkesat dhe pritshmëritë e tua do të plotësohen.

Ke të drejtë të respektosh kulturën tënde, gjuhën tënde dhe fenë tënde.

Ke të drejtë të shkosh në shkollë për të mësuar gjuhën italiane dhe të ndjekësh kurset e formimit profesional të cilat do të të ndihmojnë që të gjesh punë pasi të mbushësh 18 vjeç, në përputhje me atë që ofron territori gjatë periudhës që je në pritje, me nivelin tënd të gjuhës italiane dhe me përgatitjen tënde shkollore.

Kujtohu që nëse nuk flet mirë italisht, ke gjithmonë të drejtën të kërkosh një ndërmjetës që të të ndihmojë të kuptosh çfarë ndodh dhe të përkthejë për ty.



JO VETËM TË DREJTA, POR EDHE DETYRA...

Është detyra jote të respektosh ligjet dhe rregullat e Italisë, vendi i pritjes.
Në Itali personat që kanë më shumë se 14 vjeç janë drejtëpërdrejtë përgjegjës për krimet e kryera. Një krim është një sjellje e ndaluar nga ligji i Shtetit Italian, e dënohet me dënim penal. Qëllimi i dënimit është riedukues, pra shërben për të bërë të ditur rëndësinë e sjelljes së gabuar, në mënyrë që të pengojë që veprimi të përsëritet.
Kryerja e krimeve mund të ketë një efekt negativ për të drejtën tënde për të rinovuar lejen e qëndrimit.

Është detyra jote të respektosh rregullat e qendrës së pritjes dhe personat që po të ndihmojnë. Rregullat shërbejnë për të bërë të mundur një bashkëjetesë të qetë me të gjithë personat e qendrës dhe që të të japë mjetet për t'u rritur dhe për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe të ndërgjegjshme kur të dalësh nga qendra e pritjes.



Në Itali të gjithë të rinjtë deri në 16 vjeç duhet të shkojnë në shkollë! Në çdo rast është detyrim të ndjekësh kursin e italishtes dhe kurset e tjera të formimit që të propozohen.



Ke për detyrë të respektosh kulturën, gjuhën dhe fenë e të gjithë personave.



RRUGËT LIGJORE TË MUNDSHME...

Për të përcaktuar rrugën ligjore më të përshtatshme me situatën tënde është themelor bashkëpunimi yt në paraqitjen e historisë tënde personale dhe familjare përpara operatorëve e personave me uniformë (Forcat e Policisë).

Leja e qëndrimit për moshë të mitur dhe konvertimi i saj

Vetëm për faktin se ke ardhur në Itali në moshë të mitur ke të drejtë të kesh një leje qëndrimi për "moshë të mitur".

Në Friuli Venecia Xhulia leja e qëndrimit për moshë të mitur nuk të lejon të punosh.

Sapo të mbushësh 18 vjeç mund të të jepet një leje qëndrimi për studim/punë/në pritje të punës.

Është e drejta jote të kesh informacione për mënyrat e konvertimit dhe për dokumentet e nevojshme e për të marrë ndihmën e operatorëve të qendrës për procedurën e konvertimit.

KUJDES: nëse nuk do të kërkosh një dokument tjetër brenda 60 ditëve pas mbushjes së moshës madhore, do të jesh i parregullt e nuk do të mund të qëndrosh në Itali.

Kryerja e procedurës së njohjes së mbrojtjes ndërkombëtare
Nëse ke lënë Vendin tënd të lindjes e nuk mund ose nuk dëshiron të kthehesh përsëri aty sepse ke frikë se mos pëson persekutime sepse rrezikon të dënohesh dhe të keqtrajtohesh në mënyrë mizore si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht nëse praktikon kulturën tënde, gjuhën dhe fenë ose nëse shpreh opinionin tënd politik dhe Autoritetet e Vendit tënd nuk të ofrojnë mbrojtje, ose nëse rrezikon të humbësh jetën për shkak të situatës së dhunës së padiskriminueshme në Vendin tënd, ke të drejtë të kërkosh mbrojtje ndërkombëtare.
Kërko informacione të mëtejshme tek operatorët, ata do të të shpjegojnë procedurën për të kryer kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare dhe tutori yt do të të shoqërojë në Kuesturë për kërkesën e mbrojtjes ndërkombëtare.

Kryerja e procedurës për njohjen si person pa shtetësi
Nëse në Vendin ku ke lindur dhe/ose ke jetuar nuk mund të kesh dokumente dhe asnjë Shtet nuk të njeh si qytetar i tij, je pa shtetësi dhe ke të drejtë të kërkosh njohjen e këtij statusi dhe mbrojtje përkatëse.
Kërko informacione tek operatorët të cilët do të të shpjegojnë se çfarë do të thotë të jesh pa shtetësi, procedurën për të kërkuar njohjen e së qënit pa shtetësi dhe do të të shoqërojnë, bashkë me tutorin tënd, në këtë proces me ndihmën e një avokati, nëse është e nevojshme.

Marrja e mbrojtjes sociale
KUJDES: nëse ka njerëz që të kanë shfrytëzuar ose që kanë ndërmend ta bëjnë, që të kërcënojnë ty ose familjen tënde e duan të të detyrojnë të bësh gjera që ti nuk do, si psh. të shesësh veten, të merresh me drogë, të vjedhësh, të

lypësh, të lash xhamat e makinave tek semaforët, të punosh në fusha ose në vende të tjera për shumë orë e me pagë shumë të ulët, në Itali ka njerëz të kualifikuar që mund të të ndihmojnë.
Fol me një njeri të besueshëm për ty ose telefono numrin falas 800 290 290. Do të gjesh ndihmën që kërkon.

Kthimi vullnetar me ndihmë
Nëse mendon se ke bërë gabim të madh që ke lënë familjen dhe vendin tënd e dëshiron të kthehesh, kërko informacione tek operatorët e qendrës të cilët do të të japin informacionet e nevojshme për t'u kthyer në shtëpi në mënyrë të sigurtë.



NUMRA DHE ADRESA TË DOBISHME që mund të kontaktosh vetë në çdo moment nevoje dhe urgjence...

Karabinieri	**112**	Urgjenca për fëmijë	**114**
Policia	**113**	Urgjenca Shëndetësore	**118**

...ose edhe vetëm për të marrë informacione të mëtejshme dhe ndihmë në rast nevoje

Numri Jeshil për Kundër-trafikim	**800 290 290**
Numri Jeshil për ARCI Azilkërkuesit dhe Mbrojtje Ndërkombëtare	**800 905 570**
Numri jeshil për ata që telefonojnë nga rrjeti mobileme Lycamobile	**+39 351 137 6335**
JUMA Refugees Map Service	https://www.jumamap.com/
Numri Jeshil Kundër-diskriminimit Racial	**800 901 010**
Agensia Onu për Refugjatët – UNHCR Zyra Rajonore për Evropën e Jugut	**+39 06 802121** itaro@unhcr.org
Consiglio Italiano per i Rifugiati - CIR	**+39 06 69200114** cir@cir-onlus.org
CIR Gorizia	gorizia@cir-onlus.org
CIR Katania	catania@cir-onlus.org
Autoriteti Garantues në qark për të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve në Friuli Venecia Xhulia	pour fixer un rendez-vous : **+30 04 81386261** cr.organi.garanzia@regione.fvg.it
Autoriteti Garantues në qark për të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve në Siçili	garanteinfanziasicilia@gmail.com


SOS





"PËR HERË TË PARË, QËKUR JAM LARGUAR NGA SHTËPIA, NDJEHEM I MBROJTUR, E NUK DO TA HARROJ KURRË KËTË NDJESI"

Oumer, 16 vjeç, *Guinea Konakry*

në kujdesin e

CIR
CONSIGLIO ITALIANO PER I RIFUGIATI ONLUS

me ndihmën e

UNHCR
The UN Refugee Agency